VENDIM
Nr.916, datë 19.11.2010

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/c të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si autoritet kontraktor, të përfundojë procedurat e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i kabinës elektrike, vila nr.1, Vlorë".

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha